

Takim me përfaqësues të Bashkisë Elbasan

Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë Z. Petrit Ahmeti sëbashku me Bordin dhe stafin mirëpriti në ambjentet e ERE-s, stafin drejtues dhe Kryetarin e Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja, me qëllim vendosjen e bashkëpunimit më të ngushtë mes institucioneve, sa i përket çështjeve të interesit të përbashkët.



Përfaqësuesit e Entit Rregullator të Energjisë dhe Bashkisë Elbasan, diskutuan nga afër në lidhje me rolin që ERE ka në rregullimin dhe ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve por edhe biznesit qoftë ai prodhues i energjisë elektrike apo jo, si dhe rolin e pushtetit vendor në adresimin e çështjeve që lidhen me interesat e këtyre kategorive, si një ndërmjetës por dhe aktor me impakt të drejtëpërdrejtë në komunitet.

ERE, prezantoi kuadrin ligjor rregullues të sektorit të energjisë elektrike si dhe vendosi theksin në rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të administratës publike në lidhje me adresimin e çështjeve që impaktojnë komunitetin e që lidhen me ofrimin e një malli shumë të rëndësishëm, siç është energjia elektrike.

Nga ana e tij Kryetari i Bashkisë Elbasan, duke falenderuar ERE për organizimin e takimit dhe iniciativën, prezantoi disa nga problematikat e bashkisë të cilat lidhen me hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe çmimin e energjisë për biznesin; shërbimin e cilësisë së furnizimit dhe investimeve në zonat rurale dhe turistike të kësaj bashkie, si dhe bashkëpunimin midis aktorëve si rregullatori dhe palë të tjera për të rritur koordinimin dhe aksesin në informimin e konsumatorëve.

Takime të kësaj natyre, do të jenë gjatë këtij viti në fokusin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë, jo vetëm si një detyrë e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2022, por edhe si përmbushje e një misioni shumë të rëndësishëm të institucionit, që lidhet me promovimin e kulturës së dijes për të adresuar dhe menaxhuar më mirë nevojat dhe ankesat e Konsumatorëve.